

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje Karburanti për nevoja të Shoqërisë” Loti 1: ”Blerje Benzinë pa plumb” Loti 2: “Blerje Naftë(Eurodiesel)”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Benzinë pa plumb, Karburant Diesel

VLERA E FONDIT LIMIT: Fondi limit: 86,206,650 (tetëdhjetë e gjashtë milionë e dyqind e gjashtë mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë) lekë pa tvsh marrëveshje kuadër me disa operatorë ekonomikë ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara të ndarë në lote:

Loti 1: ”Blerje Benzinë pa plumb” me fond limit 7,305,750 (shtatë milion e treqind e pesë mijë e shtatëqind e pesëdhjetë) lekë pa tvsh.

Loti 2: “Blerje Naftë(Eurodiesel)” me fond limit 78,900,900 (shtatëdhjetë e tetë milionë e nëntëqind e nëntëdhjetë mijë) lekë pa tvsh.

Vlera e fondit Limit në monedhen nderkombetare Euro sipas kursit të Bankes së Shqipërisë për fondin e përgjithshëm është 737,187 (shtatëqind e tridhjetë e shtatë mijë e njëqind e tetëdhjetë e shtatë) pa TVSH.

Loti 1: Vlera e fondit limit në monedhen nderkombetare Euro sipas kursit të Bankes së Shqipërisë për lotin e parë është 62,474.3 (gjashtëdhjetë e dy mijë e katërqind e shtatëdhjetë e katër pikë tre) euro pa tvsh.

Loti 2: Vlera e fondit Limit në monedhen nderkombetare Euro sipas kursit të Bankes së Shqipërisë për lotin e dytë është 674,712.7 (gjashtëqind e shtatëdhjetë e katër mijë e shtatëqind e dymbëdhjetë pikë shtatë)

Kursi zyrtar i kembimit sipas Bankes të Shqipërisë datë 15/11/2022 është 116.94 euro

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar autoriteti/enti kontraktor UKT sh.a ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3 përkatësisht për lotin e parë: **Loti 1:** 146,115 (njëqind e dyzetë e gjashtë mijë e njëqind e pesëmbëdhjetë) lekë pa tvsh , si dhe në Euro 1,249.5(një mijë e dyqind e dyzetë e nëntë pikë pesë)*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”e ndryshuar

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2018, 2019, 2020 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% të fondit limit të lotit të parë.

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Nëse operatori ekonomik oferton për lote të veçanta, vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës të kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e fondit limit të lotit përkatës , ose shumë se loteve që oferton).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” e ndryshuar

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43, pika 1, pika 2, si dhe neni 64 i Ligjit Nr. 9920, datë 19.5.2008 (i ndryshuar) "Per Procedurat Tatimore ne Republikën e Shqipërisë", Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet forms elektronike".

2.2.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë pasqyrat financiare vjetore (bilancet) gjatë 3(tre) viteve të fundit (2019, 2020, 2021) të çertifikuara nga organet tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me akt-ekspertizën e ekspertit kontabël të autorizuar. Kriteri quhet i përmbushur nëse në bilancet e 2 viteve të njëpasnjëshme nuk kanë raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht në nenin 29, pika 1 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

2.2.3. Operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2022, ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas ligjit nr.9632 datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar; **(lidhur me afatet e kryerjes së pagesave të caktuara nga njesite e veteqeverisjes vendore për vitin 2022)**, në të cilën është regjistruar sipas QKB dhe vendimeve të Këshilleve Bashkiake të njësive vendore ku operatorët ushtrojnë aktivitetin.

(Në çdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

2.2.4. Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë se ka paguar detyrimet e taksave vendore për vitin 2022 sipas ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të DST-së objekt prokurimi.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Shënim: Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet të dorëzojë pranë AK, *përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit*, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, në ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 4, pika 2 d).

Referuar sa mësipër, njësia e prokurimit gjykon se kriteri i vendosur nga autoriteti kontraktor lidhur me vetëdeklarimin nga ana e operatorëve ekonomikë të vërtetimit të shlyerjes së detyrimeve vendore për vitin 2021 sipas kësteve prane bashkise/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për tju nënshtruar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

2.3Aftësitë teknike dhe profesionale:

Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limitit të lotit të parë, / shumatores së loteve për të cilën oferton.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,

ose

b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77/4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për

miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën me sukses, prandaj është kërkuar që kontratat e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufirit të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

c) Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Vlera e parashikuar e kontratës, është mbi kufirin e lartë monetar. Vlera për furnizime të ngjashme përbën një nivel të mjaftueshëm përvojë duke patur parasysh objektin dhe vlerën e fondit limit.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.

Përvoja e mëparshme është një element shumë i domosdosshëm që garanton autoritetin kontraktor se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së kontratave të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Në mbështetje të nenit 88 pika 1 e VKM 285/2021, parashikon se “Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.

Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.3.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i Certifikuar sipas standardeve ISO të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit të cilat janë të akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, konkretisht:

- a) Të disponojë Çertifikatën mbi “Sistemet e Menaxhimit të Cilësisë” ISO 9001:2015 (**ose ekuivalente**) e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit. (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zerave që do të marre persiper sipas akt-marreveshjes).

2.3.4 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i Certifikuar sipas standardeve ISO të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit të cilat janë të akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, konkretisht:

- a) Të disponojë Çertifikatën mbi “Sistemet e Menaxhimit të Ambjentit” ISO 14001:2015 (**ose ekuivalente**) e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit . (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zerave që do të marre persiper sipas akt-marreveshjes).

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë pjesëmarrës të dëshmojnë i plotësojnë kërkesat e cilësisë për mallrat që do të furnizohen, e rrjedhimisht është e drejtë e AK t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga organe të pavarura të njohura nga Sistemet e Standardizimit Kombëtar ose Ndërkombëtar.

ISO 9001 parashikon një tërësi rregullash që garantojnë një bazë rreziku parandalues ndaj cilësisë e cila mbulon një gamë të gjerë të çështjeve ku përfshihen: angazhimi i lartë i menaxhimit për cilësi nga furnizuesi, fokusin e klientit, përshtatshmërinë e burimeve të tij, kompetencen/profesionalizmin e punonjësve, procesi i menaxhimit (për prodhim, ofrimin të shërbimeve dhe proceset mbështetëse e administrative), planifikimin e cilësisë, dizenjimi i produkteve dhe shërbimet që ofron, garantimin e një procesi cilësor të furnizimit, sigurimin e konformitetit për mallrat dhe shërbimet, proceset e tij për të zgjidhur ankesat e konsumatorëve, veprime korrigjuese, dhe një kërkesë për të nxitur përmirësimin. Kjo kërkesë, dëshmon se mbajtësi i saj garanton standardet ndërkombëtare të menaxhimit të cilësisë së ushtrimit të aktivitetit tregtar të tij.

ISO 14001:2015 specifikon kërkesat për një sistem të menaxhimit mjedisor që një organizatë mund të përdorë për të përmirësuar performancën e saj mjedisore. ISO 14001:2015 është menduar për përdorim nga një organizatë që kërkon të menaxhojë përgjegjësitë e saj mjedisore në një mënyrë sistematike që kontribuon në shtyllën mjedisore të qëndrueshmërisë. ISO 14001:2015 ndihmon një organizatë të arrijë rezultatet e synuara të sistemit të saj të menaxhimit mjedisor, të cilat ofrojnë vlerë për mjedisin, vetë organizatën dhe palët e interesuara.

ISO 14001:2015 është i zbatueshëm për çdo organizatë, pavarësisht nga madhësia, lloji dhe natyra, dhe zbatohet për aspektet mjedisore të aktiviteteve, produkteve dhe shërbimeve të saj që organizata përcakton se mund t'i kontrollojë ose ndikojë duke marrë parasysh perspektivën e ciklit jetësor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79 të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020”Për Prokurimin Publik”, si dhe bazuar në nenin 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar si dhe me rekomandimin e APP, datë 20.03.2018, prot 3341/1.

2.3.5 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur me liçencë për tregtim karburantesh të llojit II/A ose autorizim për leje tregtimi karburantesh të lëshuar nga njësia e qeverisjes vendore.

Argumentimi: Në bazë të nenit të 77 pika 2 , të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/ a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” e ndryshuar.

2.3.6.Operatori ekonomik duhet të paraqesë fletë-analize për produktin Benzinë pa Plumb në përputhje me Standartin S.SH EN 228:2012 A1/2017 lëshuar nga organi kompetent ose nga një laborator shqiptar i akredituar ose i huaj i cili vërteton cilësinë e produktit objekt i kësaj

kontrate që ofertuesi tregton, sipas standarteve të përcaktuara në pajtueshmëri me specifikimet teknike e lëshuar brenda 3 muajve të fundit nga data e hapjes së ofertave.

Argumentimi: Në bazë të nenit të 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 6/ c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” e ndryshuar me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të paraqesin dëshmi të testeve zyrtare të cilat provojnë përmbushjen e karakteristikave teknike të mallrave objekt të prokurimit. Nisur nga fakti se objekt i kësaj kontrate janë furnizimi me karburant për automjetet të cilat duhet të funksionojnë sipas specifikimeve teknike të tyre, duhet të dëshmojnë që produkti ka minimalisht, karakteristikat teknike të kërkuara. Ky kriter është vendosur, gjithashtu edhe për arsye se është çmuar si e nevojshme që cilësia e mallit ndikon drejtpërdrejt në automjetet në të cilat do të përdoret pasi nëse produkti nuk do të plotësonte minimalisht karakteristikat teknike të kërkuara ai do dëmtonte automjetet ose pajisjet teknike.

2.3.6. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një vërtetim të lëshuar nga ISHTI, për lotin që oferton se subjekti ofertues, nuk ka patur penalitete për shkelje të cilësisë për vitin 2022.

Nëse operatorët ekonomikë janë bashkim operatorësh secili prej tyre duhet të paraqesë një vërtetim të lëshuar nga ISHTI për lotin që oferton se subjekti ofertues nuk ka patur penalitete për shkelje të cilësisë për vitin 2022.

Argumentimi: Në bazë të nenit të 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”.

2.3.7. Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur me vërtetim teknik të lëshuar nga ISHTI ose nga subjekte private të akredituara në Republikën e Shqipërisë, leje mjedisore të tipit B lëshuar nga QKL, akt teknik të lëshuar nga PMNZH dhe policë sigurimi lëshuar nga shoqëritë e sigurimeve që operojnë në Republikën e Shqipërisë.

Keto kërkesa janë vendosur sipas përcaktimit të bërë në mbështetje të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, Neni 77, pika 1 gërma c).

2.3.8 Subjekti ofertues duhet të garantojë me shkrim se merr përsipër furnizimin e pandërprerë me karburant në të paktën 7(shtatë) pika karburanti brenda bashkisë të Tiranës vërtetuar nëpërmjet një nga format e Kodit Civil (kontratë qeraje, ose akt pronësie ose të jenë të pasqyruara në ekstraktin e QKB) pika për të cilat do të shërbejnë për furnizimin e Autoritetit Kontraktor. Pikat e karburantit duhet të jenë të pajisura me vërtetim teknik të lëshuara nga ISHTI ose nga subjekte të akredituara në Republikën e Shqipërisë, leje mjedisore të lëshuar nga QKL, akt teknik të lëshuar nga PMNZH dhe policë sigurimi lëshuar nga shoqëritë e sigurimeve që operojnë në Republikën e Shqipërisë.

- ***Bazuar në VKM Nr 561 date 29.07.2016, “Per Standartizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve të karburantit në njesitë e qeverisjes së përgjithshme“ Operoret ekonomik pjesëmarrës duhet të ofrojnë një faqe menaxhimi të karburanteve (ëebpage), ku furnizimi***

dhe shpenzimi i karburantit per mjetet efektive te transportit te kryhet nepemjet kartes elektronike.

- *Faqja e menaxhimit te karburanteve (ëebpage) duhet te ofroje sherbimin e ngarkimit te sasise se karburantit nga Operatori ekonomik drejt Autoritetit Kontraktor, me qellim qe rimbushja e kartave elektronike te personalizuar me targon e mjetit si dhe administrimi i sasise se karburanteve te kryhet nga vet Autoriteti kontraktor.*
- *Faqja e menaxhimit te karburanteve duhet te ofroje edhe sherbimin per krijimin e struktures piramidale ne perputhje me strukturen piramidale te Autoritetit kontraktor, sherbimin e furnizimit me karburant nepermjet kartave elektronike per çdo furnizim te kryer te mjetit prane stacionit te shitjes se karburanteve me pakice me qellim identifikimin e mjetit dhe perdoruesit te saj .*
- *Me qellim disponimin /ekzistencën e faqes se menaxhimit te karburanteve (ëebpage), se bashku me ofrimin e shërbimeve të kerkuara mësipër operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të paraqesin në sistemin elektronik faqen e menaxhimit të karburanteve.*
- *Mos ofrimi i sherbimeve te kerkuara mesiper ne menyre elektronike nepermjet Faqes se menaxhimit te karburanteve (ëebpage), qe ofron cdo operator ekonomik pjesemarrës perben kusht per s'kualifikim.*

Arkumentimi: Kriteret për kualifikim vendosen që ti shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet ekonomike dhe financiare, kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës.

Në këtë kuptim, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet dhe të vërtetohet që operatori ekonomik gëzon dhe zotëron kapacitetin teknik , duke krijuar bindjen tek Autoriteti Kontraktor se operatori ekonomik kontraktues do të realizojë kontratën me sukses.

Lidhur me numrin e pikave të furnizimit me njësia e prokurimit gjykon se është marrë në konsideratë shtrirja e madhe e territorit ku ushtron aktivitetin dhe funksionet e saj UKT sh.a.

Duke marrë parasysh vendodhjen dhe shpërndarjen e zyrave të UKT sh.a në një territor të gjerë sh.a siç janë Drejtoria Qëndrore e UKT sh.a, Drejtoria e Transport Oficinës, Drejtoria e Impiantit Bovillë, Stacioni i Pompimit të Shën Mërisë në Dajt, Depo Partitar, Stacion Pompimi Kroi etj, është e nevojshme disponimi i 7(shtatë) pikave të karburantit.

Gjithashtu theksojmë se në VKM nr.285 datë 19.05.2021 “Rregullat e Prokurimit Publik”i ndryshuar parashikon instrumenta të tjerë në mënyrë që operatorët ekonomikë të bëhen pjesë e procedurave të prokurimit publik që zhvillojnë Autoritetet Kontraktore.

Konkretisht në nenin 88 të VKM nr.285 ,datë 19.05.2021”Rregullat e Prokurimit Publik”i ndryshuar jep mundësinë operatorëve ekonomikë që të bëhen pjesë e procedurave të prokurimit të zhvilluara nga AK edhe nëpërmjet bashkimit të operatorëve ekonomikë.

2.3.10. Malli do të ofrohet me karta elektronike të personalizuar ose me autobot sipas nevojave të Autoritetit Kontraktor.Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kërkojë furnizim sa herë të ketë ta ketë të nevojshme duke e realizuar këtë kërkesë me shkrim në mënyrë zyrtare.

2.3.11.Sasia e Karburantit do të jetë e disponueshme për tu tërhequr nëpërmjet kartave elektronike në të gjitha pikat e karburantit të operatorit ekonomik ofertues ose me autobot sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktor.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Në të gjitha rastet kur përmendet çertifikatë ,markë,emër i veçantë , patentë,vizatim ose tip,origjine specifike,prodhues ose sipërmarrës pranohet edhe ekuivalent i tyre.

Loti 2: ” Blerje Naftë(Eurodiesel)”

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3 përkatësisht për lotin e dytë në vlerën: **Loti 2:** 1,578,018 (një milion e pesëqind e shatatëdhjetë e tetë mijë e tetëmbëdhjetë) lekësi dhe për operatorët ekonomikë të huaj në Euro: 13,494.25(trembëdhjetë mijë e katërqind e nëntëdhjetë e katër pikë njëzetë e pesë)*

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

2.1.Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2018, 2019, 2020 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% të fondit limit të lotit të dytë.

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Nëse operatori ekonomik oferton për lote të veçanta, vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës të kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e fondit limit të lotit përkatës , ose shumës se loteve që oferton).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” e ndryshuar

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohej, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43 , pika 1 , pika 2 , si dhe neni 64 i Ligjit Nr. 9920, datë 19.5.2008 (i ndryshuar) “Per Procedurat Tatimore ne Republikën e Shqipërisë”, Udhëzimit të Ministrisë të Financave nr.5, datë

30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet forms elektronike".

2.2.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë pasqyrat financiare vjetore (bilancet) gjatë 3(tre) viteve të fundit (2019, 2020, 2021) të çertifikuar nga organet tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me akt-ekspertizën e ekspertit kontabël të autorizuar. Kriteri quhet i përmbushur nëse në bilancet e 2 viteve të njëpasnjëshme nuk kanë raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht në nenin 29, pika 1 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

2.2.3. Operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2022, ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas ligjit nr.9632 datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar; **(lidhur me afatet e kryerjes se pagesave te caktuara nga njesite e veteqeverisjes vendore për vitin 2022)**, në të cilën është regjistruar sipas QKB dhe vendimeve të Këshilleve Bashkiake të njësive vendore ku operatorët ushtrojnë aktivitetin.

(Në çdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

2.2.4. Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë se ka paguar detyrimet e taksave vendore për vitin 2022 sipas ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të DST-së objekt prokurimi.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Shënim: Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet të dorezojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, në ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 “Per procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 4, pika 2 d).

Referuar sa mësipër, njësia e prokurimit gjykon se kriteri i vendosur nga autoriteti kontraktor lidhur me vetëdeklarimin nga ana e operatorëve ekonomikë të vertetimit të shlyerjes së detyrimeve vendore për vitin 2021 sipas kësteve prane bashkise/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për tju nënshtuar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

2.3Aftësitë teknike dhe profesionale:

Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit të limitit të lotit të dytë, ose në vlerë jo më të vogël se 40% e shumës së fondit limitit të vënë në dispozicion për lotet që oferton).

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- d) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
ose
- e) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77/4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 40, pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën me sukses, prandaj është kërkuar që kontratat e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limitit, që është brenda vlerës kufirit të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Vlera e parashikuar e kontratës, është mbi kufirin e lartë monetar. Vlera për furnizime të ngjashme përbën një nivel të mjaftueshëm përvoja duke patur parasysh objektin dhe vlerën e fondit limit.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.

Përvoja e mëparshme është një element shumë i domosdosshëm që garanton autoritetin kontraktor se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së kontratave të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Në mbështetje të nenit 88 pika 1 e VKM 285/2021, parashikon se “Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.

Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.3.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i Certifikuar sipas standardeve ISO të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit të cilat janë të akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, konkretisht:

- a) Të disponojë Çertifikatën mbi “Sistemet e Menaxhimit të Cilësisë” ISO 9001:2015 (**ose ekuivalente**) e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit. (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zerave që do të marre persiper sipas akt-marreveshjes).

2.3.4 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i Certifikuar sipas standardeve ISO të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit të cilat janë të akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, konkretisht:

- b) Të disponojë Çertifikatën mbi “Sistemet e Menaxhimit të Ambjentit” ISO 14001:2015 (**ose ekuivalente**) e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit . (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zerave që do të marre persiper sipas akt-marreveshjes).

Me anë të këtij kriteri kërkohej që operatorët ekonomikë pjesëmarrës të dëshmojnë i plotësojnë kërkesat e cilësisë për mallrat që do të furnizohen, e rrjedhimisht është e drejtë e AK t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga organe të pavarura të njohura nga Sistemet e Standardizimit Kombëtar ose Ndërkombëtar.

ISO 9001 parashikon një tërësi rregullash që garantojnë një bazë rreziku parandalues ndaj cilësisë e cila mbulon një gamë të gjerë të çështjeve ku përfshihen: angazhimi i lartë i

menaxhimit për cilësi nga furnizuesi, fokusin e klientit, përshtatshmërinë e burimeve të tij, kompetencen/profesionalizmin e punonjësve, procesi i menaxhimit (për prodhim, ofrimin të shërbimeve dhe proceset mbështetëse e administrative), planifikimin e cilësisë, dizenjimi i produkteve dhe shërbimet që ofron, garantimin e një procesi cilësor të furnizimit, sigurimin e konformitetit për mallrat dhe shërbimet, proceset e tij për të zgjidhur ankesat e konsumatorëve, veprime korrigjuese, dhe një kërkesë për të nxitur përmirësimin. Kjo kërkesë, dëshmon se mbajtësi i saj garanton standardet ndërkombëtare të menaxhimit të cilësisë së ushtrimit të aktivitetit tregtar të tij.

14001:2015 specifikon kërkesat për një sistem të menaxhimit mjedisor që një organizatë mund të përdorë për të përmirësuar performancën e saj mjedisore. ISO 14001:2015 është menduar për përdorim nga një organizatë që kërkon të menaxhojë përgjegjësitë e saj mjedisore në një mënyrë sistematike që kontribuon në shtyllën mjedisore të qëndrueshmërisë. ISO 14001:2015 ndihmon një organizatë të arrijë rezultatet e synuara të sistemit të saj të menaxhimit mjedisor, të cilat ofrojnë vlerë për mjedisin, vetë organizatën dhe palët e interesuara.

ISO 14001:2015 është i zbatueshëm për çdo organizatë, pavarësisht nga madhësia, lloji dhe natyra, dhe zbatohet për aspektet mjedisore të aktiviteteve, produkteve dhe shërbimeve të saj që organizata përcakton se mund t'i kontrollojë ose ndikojë duke marrë parasysh perspektivën e ciklit jetësor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79 të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", si dhe bazuar në nenin 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" si dhe me rekomandimin e APP, datë 20.03.2018, prot 3341/1.

2.3.5 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur me liçencë për tregtim karburantesh të llojit II/A ose autorizim për leje tregtimi karburantesh të leshuar nga njësi e qeverisjes vendore.

Argumentimi: Në bazë të nenit të 77 pika 2 , të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 40, pika 5/ a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" e ndryshuar.

2.3.6. Operatori ekonomik duhet të paraqesë fletë-analize për produktin Diesel në përputhje me Standartin S.SH.EN 590-2013 A1/2017 leshuar nga organi kompetent ose nga një laborator shqiptar i akredituar ose i huaj i cili vërteton cilësinë e produktit objekt i kësaj kontrate që ofertuesi tregon, sipas standarteve të përcaktuara në pajtueshmëri me specifikimet teknike e leshuar brenda 3 muajve të fundit nga data e hapjes së ofertave.

Argumentimi: Në bazë të nenit të 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 40, pika 6/ c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të

Prokurimit Publik” e ndryshuar me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të paraqesin dëshmi të testeve zyrtare të cilat provojnë përmbushjen e karakteristikave teknike të mallrave objekt të prokurimit. Nisur nga fakti se objekt i kësaj kontrate janë furnizimi me karburant për automjetet të cilat duhet të funksionojnë sipas specifikimeve teknike të tyre, duhet të dëshmojnë që produkti ka minimalisht, karakteristikat teknike të kërkuara. Ky kriter është vendosur, gjithashtu edhe për arsye se është çmuar si e nevojshme që cilësia e mallit ndikon drejtpërdrejt në automjetet në të cilat do të përdoret pasi nëse produkti nuk do të plotësonte minimalisht karakteristikat teknike të kërkuara ai do dëmtonte automjetet ose pajisjet teknike.

2.3.6. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një vërtetim të lëshuar nga ISHTI, për lotin që oferton se subjekti ofertues, nuk ka patur penalitete për shkelje të cilësisë për vitin 2022.

Nëse operatorët ekonomikë janë bashkim operatorësh secili prej tyre duhet të paraqesë një vërtetim të lëshuar nga ISHTI për lotin që oferton se subjekti ofertues nuk ka patur penalitete për shkelje të cilësisë për vitin 2022.

Argumentimi : Vendosja e kriterit të sipërcituar është vendosur në bazë të nenit të 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”.

2.3.7. Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur me vërtetim teknik të lëshuar nga ISHTI ose nga subjekte private të akredituara në Republikën e Shqipërisë, leje mjedisore të tipit B lëshuar nga QKL, akt teknik të lëshuar nga PMNZH dhe policë sigurimi lëshuar nga shoqëritë e sigurimeve që operojnë në Republikën e Shqipërisë.

Keto kërkesa janë vendosur sipas përcaktimit të bërë në mbështetje të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, Neni 77, pika 1 gërma c).

2.3.8 Subjekti ofertues duhet të garantojë me shkrim se merr përsipër furnizimin e pandërprerë me karburant në të paktën 7(shtatë) pika karburanti brenda bashkisë të Tiranës vërtetuar nëpërmjet një nga format e Kodit Civil (kontratë qeraje, ose akt pronësie ose të jenë të pasqyruara në ekstraktin e QKB) pika për të cilat do të shërbejnë për furnizimin e Autoritetit Kontraktor. Pikat e karburantit duhet të jenë të pajisura me vërtetim teknik të lëshuara nga ISHTI ose nga subjekte të akredituara në Republikën e Shqipërisë, leje mjedisore të lëshuar nga QKL, akt teknik të lëshuar nga PMNZH dhe policë sigurimi lëshuar nga shoqëritë e sigurimeve që operojnë në Republikën e Shqipërisë.

- ***Bazuar në VKM Nr 561 date 29.07.2016, “Per Standartizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve të karburantit në njesite e qeverisjes së përgjithshme“ Operoret ekonomik pjesëmarrës duhet të ofrojnë një faqe menaxhimi të karburanteve (ëëbpage), ku furnizimi dhe shpenzimi i karburantit për mjetet efektive të transportit të kryhet nëpërmjet kartës elektronike.***

- *Faqja e menaxhimit të karburanteve (ëebpage) duhet të ofroje shërbimin e ngarkimit të sasise së karburantit nga Operatori ekonomik drejt Autoritetit Kontraktor, me qëllim që rimbushja e kartave elektronike të personalizuar me targonë e mjetit si dhe administrimi i sasise së karburanteve të kryhet nga vet Autoriteti kontraktor.*
- *Faqja e menaxhimit të karburanteve duhet të ofroje edhe shërbimin për krijimin e strukturës piramidale në përputhje me strukturën piramidale të Autoritetit kontraktor, shërbimin e furnizimit me karburant nëpërmjet kartave elektronike për çdo furnizim të kryer të mjetit pranë stacionit të shitjes së karburanteve me pakice me qëllim identifikimin e mjetit dhe perdoruesit të saj .*
- *Me qëllim disponimin /ekzistencën e faqes së menaxhimit të karburanteve (ëebpage), së bashku me ofrimin e shërbimeve të kërkuara mësipër operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të paraqesin në sistemin elektronik faqen e menaxhimit të karburanteve.*
- *Mos ofrimi i shërbimeve të kërkuara mesipër në mënyrë elektronike nëpërmjet Faqes së menaxhimit të karburanteve (ëebpage), që ofron cdo operator ekonomik pjesëmarrës përben kusht për s'kualifikim.*

Arkumentimi: Kriteret për kualifikim vendosen që ti shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet ekonomike dhe financiare, **kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative,** makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin **dhe besueshmërinë**, përvojën e duhur, **si dhe personelin e nevojshëm**, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës.

Në këtë kuptim, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet dhe të vërtetohet që operatori ekonomik gëzon dhe zotëron kapacitetin teknik , duke krijuar bindjen tek Autoriteti Kontraktor se operatori ekonomik kontraktues do të realizojë kontratën me sukses.

Lidhur me numrin e pikave të furnizimit me njësi e prokurimit gjykon se është marrë në konsideratë shtrirja e madhe e territorit ku ushtron aktivitetin dhe funksionet e saj UKT sh.a.

Duke marrë parasysh vendodhjen dhe shpërndarjen e zyrave të UKT sh.a në një territor të gjerë sh.a siç janë Drejtoria Qëndrore e UKT sh.a, Drejtoria e Transport Oficinës, Drejtoria e Impiantit Bovillë, Stacioni i Pompimit të Shën Mërisë në Dajt, Depo Partitar, Stacion Pompimi Kroj etj, është e nevojshme disponimi i 7(shtatë) pikave të karburantit.

Gjithashtu theksojmë se në VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Rregullat e Prokurimit Publik”i ndryshuar parashikon instrumenta të tjerë në mënyrë që operatorët ekonomikë të bëhen pjesë e procedurave të prokurimit publik që zhvillojnë Autoritetet Kontraktore.

Konkretisht në nenin 88 të VKM-së nr.285 , datë 19.05.2021”Rregullat e Prokurimit Publik”i ndryshuar jep mundësinë operatorëve ekonomikë që të bëhen pjesë e procedurave të prokurimit të zhvilluara nga AK edhe nëpërmjet bashkimit të operatorëve ekonomikë.

2.3.10. Malli do të ofrohet me karta elektronike të personalizuar ose me autobot sipas nevojave të Autoritetit Kontraktor. Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kërkojë furnizim sa herë të ketë ta ketë të nevojshme duke e realizuar këtë kërkesë me shkrim në mënyrë zyrtare.

2.3.11. Sasia e Karburantit do të jetë e disponueshme për tu tërhequr nëpërmjet kartave elektronike në të gjitha pikat e karburantit të operatorit ekonomik ofertues ose me autobot sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktor.

2.3.12. Operatori ekonomik duhet të disponojë në pronësi apo me qera, apo çdo lloj forme e parashikuar nga Kodi Civil minimumi 2 mjete (autobot) me kapacitet mbajtës deri në 1000 l dhe 1 (një) mjet autobot me kapacitet mbajtës deri në 5000 litra.

Për të vërtetuar disponimin e mjeteve të kërkuara më lart operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

a) *Për këto mjete që shënohen në regjistra publikë në rastin e pronësisë duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit (te vlefshme), certifikatën për transportin e mallrave të rrezikshme, pasaportën e autobotit, certifikatën e mbrojtjes nga zjarri dhe certifikaten e verifikimit të kontaltrit të leshuar nga DPM dhe për mjetet e siguruar me qera, kontratën e qerasë (e vlefshme) shoqëruar me dokumentin që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit (te vlefshme), certifikatën për transportin e mallrave të rrezikshme, pasaportën e autobotit, certifikatën e mbrojtjes nga zjarri dhe certifikaten e verifikimit të kontaltrit të leshuar nga DPM.*

Shënim: Për pikat e mësipërme operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës nr.8.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Shënim: Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet të dorëzojë pranë AK, **përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit**, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77/1 gërma c), neni 77 pika 4 të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", si dhe bazuar në nenin 40 pika 5 gërma ç) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" si dhe me rekomandimin e APP, datë 20.03.2018, prot 3341/1.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Në të gjitha rastet kur përmendet certifikatë, markë, emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjine specifike, prodhues ose sipërmarrës pranohet edhe ekuivalent i tyre